

VENDIM
Nr.698, datë 12.10.2011

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR
RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 8 BASHKI DHE 10
KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 8 (tetë) bashki dhe 10 (dhjetë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi, në vlerën 37 720 925 lekë (tridhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e njëzet mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekësh, përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (në lekë)
1	Bashkia Kuçovë	3,233,100
2	Bashkia Rrëshen	4,311,250
3	Bashkia Bilisht	3,184,500
4	Bashkia Peqin	864,295
5	Bashkia Fier	18,244,500
6	Bashkia Patos	3,315,100
7	Bashkia Çorovodë	576,000
8	Bashkia Korçë	485,625
9	Komuna Papër	466,930
10	Komuna Bupq	382,000
11	Komuna Ishëm	604,531
12	Komuna Udënisht (Pogradec)	112,000
13	Komuna Q.Bulgarec	470,775
14	Komuna Zharrëz	618,750
15	Komuna Perondi	226,834
16	Komuna Mollas	20,486
17	Komuna Kozarë	251,250
18	Komuna Qendër (Fier)	352,999
	Shuma	37,720,925